


KULTURA



Ndërkohë, autori i librit i cili ka pasur një qëndrim katërvjeçar në Kosovë dhe dy vjet angazhim rreth këtij libri, ka thënë para të pranishmëve se ky libër është i domosdoshëm duke pasur parasysh Kosovën si shtet të vogël për një artist kaq të madh

sikur që është Luan Mulliqi. "Për këtë arsye ky libër është botuar në tri gjuhë: shqipe, angleze dhe gjermane, pasi me këtë mund të bëhet diplomaci", ka thënë Gunther, duke shtuar se atë që s'mund ta bëjë politika, e bën arti.



Kur arti merr rolin e politikës

Ardianë Pajaziti

"Mulliqi", një skulptor i madh, titullohet libri i profesorit austriak Johann Gunther, libër monografik për skulptorin e mirënjohur kosovar Luan Mulliqi, i cili është promovuar para një numri të madh të pjesëmarrësve në Bibliotekën

Duke u falënderuar për punën e Gunther, i cili ka promovuar kulturën shqiptare nëpër vende të ndryshme, ai ka marrë të drejtën që ta quajë edhe ambasador të vërtetë të kulturës në të gjitha fushat.

Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës. Aty ishin edhe Pieter Faith dhe Edita Tahiri. Piktori Rexhep Ferri para të pranishmëve ka thënë se kur flitet për autoportretin e Luanit mund të thuhet se kemi të bëjmë me një krijues të takimeve miqësore të cilat i ka parqitur në këtë monografi, profesionalisht të pastërt, për ta promovuar atë si diçka të re.

Kurse ambasadori i Ambasadës së Austrisë në Kosovë, Johann Brieger, ka spikatur disa nga faktet

që Austria është mike e Kosovës, duke u ndalur edhe në mbështetjen e fundit të botimit të librit "Mulliqi", që dëshmon vazhdimësinë e kësaj miqësie.

Ndërkohë, autori i librit i cili ka pasur një qëndrim katërvjeçar në Kosovë dhe dy vjet angazhim rreth këtij libri, ka thënë para të pranishmëve se ky libër është i domosdoshëm duke pasur parasysh Kosovën si shtet të vogël për një artist kaq të madh sikur që është Luan Mulliqi. "Për këtë arsye ky libër është botuar në tri gjuhë: shqipe, angleze dhe gjermane, pasi me këtë mund të bëhet diplomaci", ka thënë Gunther, duke shtuar se atë që s'mund ta bëjë politika, e bën arti. "Ideja ime është që Luan Mulliqi është Luan Mulliqi. Është artist i nivelit ndërkombëtar dhe i jep vendit tuaj një imazh tjetër", ka thënë ai. Më pas duke specifikuar për ecurinë e Mulliqit në këtë libër që nga fëmijëria e deri te veprat e fundit ai ka veçuar skulpturat e femrës shtatzënë të autorit

Mulliqi, i cili këtë vepër arti e ka personifikuar me shtetin e Kosovës duke aluduar në foshnjën në barkun e nënës në skulpturë.

Në anën tjetër, personazhi i kësaj ngjarjeje, Luan Mulliqi është shprehur të ketë emocione më të theksuara për faktin se bëhet fjalë për një autor global. Duke u falënderuar për punën e Gunther, i cili ka promovuar kulturën shqiptare nëpër vende të ndryshme, ai ka marrë të drejtën që ta quajë edhe ambasador të vërtetë të kulturës në të gjitha fushat. "Shpresoj që të ketë edhe bashkëpunime të tjera mes Kosovës dhe Austrisë", ka thënë Mulliqi. Ndërkohë, për vetë librin "Mulliqi", skulptori Luan Mulliqi ka thënë për Zëri se është hera e parë që po bëhet një libër monografik nga një autor i huaj për një artist kosovar.

"Nuk kanë bërë as institucionet sa ka bërë Gunther për promovimin e kulturës shqiptare", ka thënë Mulliqi, i cili ka specifikuar faktin se përgjatë misionit të

Gunther në Kosovë prioritet i tij ka qenë promovimi i kulturës kosovare. "Ai e ka vërejtë se ne nuk kemi aq njohuri për diplomaci kulturore dhe për këtë fakt na ka ndihmuar shumë", ka thënë Mulliqi.

Se nëse posedon një libër të tillë të bërë nga një autor vëndës, Mulliqi ka pohuar se nuk ka ndonjë libër të tillë, dhe sipas tij, fakeqësisht në Kosovë akoma jemi në atë situatë kur vlerësohemi më shumë nga të huajt.

Libri është mbështetur nga Ambasada e Austrisë në Kosovë dhe Ministria për Kulturë, Rini dhe Sporte, kurse në librin e prezantuar me 168 faqe janë përfshirë fëmijëria e Mulliqit deri te veprat e fundit, fotografite e skulpturave të Mulliqit, fotografite e Mulliqit me personalitete të ndryshme, pjesë të gazetave për Mulliqin, dhe përshtypjet nga të tjerët për Mulliqin, për të cilin kanë shkruar edhe Ismail Kadare, Ali Podrimja, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Beqë Cufaj, Eliza Hoxha...